



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1178 Prot.

Elbasan, më 28.02. 2024

Vendim

Nr 28 / Datë 28/02/2024

Për përcaktimin e përgjegjësiave dhe kompetencave

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrative të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8,9, 59 e 64 të tij, ligjin 44 datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, nenet 28 e 29 të tij,

Vendosa

- 1- Zv/Kryetari i Bashkisë z. Armand Shehu, është përgjegjës për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin, e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë dhe strukturave vartëse të saj.
- 2- Në funksion të realizimit të përgjegjësiave si më sipër, Zv/Kryetari z. Armand Shehu i delegohen kompetencat si më poshtë:
  - *Të kontrollojë, shqyrtojë dhe nënshkruaj të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësiave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.*
  - *Kur për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë urdhër, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë*
  - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësiave të përcaktuara në këtë urdhër dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij*
- 3- Gjithashtu, zv/kryetari z. Armand Shehu është përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e aktivitetit të Qendrës Sociale “Balashe” dhe Njësisë së Menaxhimit të Banesave Sociale
- 4- Aktet dhe shkresat zyrtare të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njelloj të detyrueshme, për administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.

- 5- Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 28/02/2024 deri në një urdhër të dytë.
- 6- Zv Kryetari z. Arman Shehu nuk mund të delegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera
- 7- Zv/kryetari z. Armand Shehu do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim
- 8- Urdhëri administrative nr 2476 date 31.10.2023 dhe të gjitha aktet e tjera të delegimit të kompetencave për ish zv/kryetarin z. Jetjon Gjura, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi
- 9- Ngarkohen zv/kryetari z. Armand Shehu dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias me publikimin e tij
- 10- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë

Drejt. B. Nj.  
Drejt. Juridike  
DPSHO

L. Dervishi  
A. Hoxha  
G. Dyrmyshi

